

Programi

Zhvillimi i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile

Shkolla e parë e lartë profesionale, për studime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.



+383 (0) 38 600 237



www.cactus.education



apply@cactus.education



Prishtinë dhe Prizren



Cactus Education është shkollë e lartë profesionale e nivelit të V e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe e licensuar nga MASHT-i.

Programi: Zhvillimi i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile

Programi për drejtimin “Zhvillim i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile” është dizajnuar që të përgatisë kandidatët për të filluar dhe ndërtuar karrierë në programim, si anëtar i ekipit në kompani ose si i vetëpunësuar.

Programi ofron njohjen me gjuhët programuese, platformat, metodologjitë dhe teknikat më të fundit në fushën e zhvillimit të softuerit, duke përfshirë bazat teorike dhe praktike nga: programimi i orientuar në objekte, algoritmet dhe strukturat e të dhënave, zhvillimi i aplikacioneve, korniza programuese MVC, serviset API, zhvillimi i aplikacioneve mobile, ndërfaqja dhe përdorimi, teknikat e mbledhjes së kërkesave, sistemet në kohë reale, siguria për ueb dhe platformat mobile, inteligjenca artificiale, rrjetat dhe IP adresimi, si dhe teoritë kryesore për ndërmarrësi dhe inovacion, modelet e biznesit, burimet e financimit të biznesit, etj.

Programi ndërthur paraqitjen e koncepteve teorike me ushtrimet laboratorike dhe detyrat reale të punës praktike që nga dita e parë. Kandidatët që kryejnë këtë program janë kompetitiv dhe të krahasueshëm me punëtorët e kësaj lëmie që kanë përvojë praktike 2 vjeçare. Ata janë në gjendje të kryejnë detyrat e punës me mbikëqyrje minimale, kanë shkathtësi dhe aftësi për të zgjidhur problemet praktike në mënyrë kritike dhe kreative, kanë bazamentin e mjaftueshëm teorik dhe janë të hapur për mësim dhe ide të reja në rrugëtimin e pandalshëm të zhvillimit teknologjik.

Programi “Zhvillimi i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile” përgatitë kandidatët me shkathtësi si:

- Zhvillim të zgjidhjeve digjitale që plotësojnë nevojat e klientit
- Zhvillim i front-end dhe back-end
- Integrim i uebfaqeve
- Zhvillim i objekteve dhe strukturave
- Zhvillim i aplikacioneve
- Zhvillim i aplikacioneve mobile
- Dizajn dhe zhvillim i bazave të të dhënave
- Zhvillim i komponenteve duke përdorur gjuhë të adaptuara për ueb-in
- Zhvillim i ndërfaqes së përdoruesit
- Implementim i prototipit të aplikacionit dhe menaxhim i zbatimit
- Menaxhim të projekteve

Kohëzgjatja:

Programi ‘Zhvillimi i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile’ është program dy vjeçar i ndarë në 4 semestra; Viti i parë përmban 60 ECVET kredi dhe viti i dytë 60 ECVET kredi. Rrjedhimisht, fondi i përgjithshëm i orëve për katër semestrat e shkollimit të këtij profili për të gjitha lëndët është 2,400 orë, respektivisht 120 ECVET kredi (1 ECVET – 20 orë) sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës.

Metodologjia e mësimi:

Programi është i strukturuar me qëllim që të sjellë një simulim të vërtetë të ambientit të punës në industrinë e teknologjisë. Rëndësia e aspektit teorik dhe akademik në program është e theksuar, duke u përqendruar në përdorimin e një qasjeje të ngjashme me atë që gjen në fushën e punës për të zhvilluar profesionistë dhe udhëheqës të ardhshëm në këtë industri. Metoda e punës në klasë synon të ndërtojë dijen e kandidatëve mbi bazën e njohurive të tyre të fituara nga mësimi paraprak i materialeve mësimore.

Programi përqendrohet që kandidatët t’i aftësojë se si të përballen me sfidat dhe kërkesat që do të kenë në të ardhmen e tyre: të aftësohen në aspektet se si mësohet, si gjendet informata, si të bëhen konkurrent në vendin e punës por edhe në tregun global, si të bëhen kritik dhe kreativ, si të bëhen produktiv për shoqërinë dhe për botën në përgjithësi.

Mësimi praktik bazohet në përvojën e drejtpërdrejtë të kandidatëve me situata reale dhe detyra praktike që ata do të përballen në karrierën e tyre të ardhshme. Ky lloj mësimi inkurajon angazhimin aktiv të kandidatëve dhe zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për të aplikuar njohuritë teorike në situata praktike. Mësimi praktik përfshinë elementet si: Projekte praktike, Simulime dhe skenarë, Studime rastesh, Demonstrim.

Lista e moduleve të drejtimit “Zhvillimi i Ueb-it dhe Aplikacioneve Mobile”

Moduli	Semestri	ECVET
Gjuhë angleze për TI	I	4
Bazat e Ueb-it	I	4
Matematikë për shkencat kompjuterike	I	6
Bazat e TIK	I	8
Hyrje në programim	I	8
Inxhinieria softuerike	III	6
Zhvillimi i Ueb-it	III	7
Zhvillimi i aplikacioneve mobile	III	7
Dizajni i ndërfaqes së përdoruesit dhe përdorshmëria	III	6
Lëndë zgjedhore	III	4

Moduli	Semestri	ECVET
Algoritmet dhe strukturat e të dhënave	II	6
Dizajnimi dhe zhvillimi i bazave të të dhënave	II	8
Programimi i Ueb-it interaktiv	II	4
Programimi i orientuar në objekte	II	8
Lëndë zgjedhore	II	4
Zhvillimi i avancuar i Ueb-it	IV	7
Zhvillimi i avancuar i aplikacioneve mobile	IV	7
Hyrje në siguri kibernetike	IV	6
Analiza dhe vizuelizimi i të dhënave	IV	6
Lëndë zgjedhore	IV	4

Lëndët Zgjedhore:

Moduli	Semestri	ECVET
Hyrje në biznes	Z	4
Hyrje në shitje	Z	4
Menaxhimi i projekteve në TI	Z	4
Testimi i Softuerit	Z	4
Intelegjenca Artificiale	Z	4
Ndërmarrësia dhe inovacioni	Z	4
Marketingu Digjital	Z	4

1. Gjuhë angleze për TI

Moduli ofron pjesë teorike dhe praktike për t'i pajisur kandidatët me njohuri thelbësore të terminologjisë së gjuhës angleze në fushat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si fusha e programit, rrjetave, sistemeve, etj. Kandidati do të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë literaturën dhe materialet nga fusha e TI-së, specifikacionet teknike, dokumentacionin e projekteve të TI-së. Do të jetë i aftë të hartojë draftet e specifikacioneve, dokumentacionin dhe ofertat për produkte dhe shërbime të TI-së dhe t'i komunikojë ato në gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim.

2. Bazat e UEB-it

Moduli përfshin konceptet dhe praktikën e nevojshme për krijim të përmbajtjes në Internet. Moduli do të ofrojë pamjen e përgjithshme teknike të Internetit në kuptimin e gjerë dhe strukturës së World Wide Web (WWW) në veçanti. Segmentet teknike do të fokusohen në dizajnin dhe implementimin efektiv të uebfaqeve në nivelin e klientit (client side ose front-end).

3. Matematikë për shkencat kompjuterike

Qëllimi kryesor i lëndës është mësimi i parimeve themelore të matematikës të cilat kanë të bëjnë me të gjitha fushat, veçanërisht me shkencat kompjuterike. Kandidatët do të forcojnë njohuritë e tyre nga shkolla e mesme duke mësuar bazat e llogaritjes dhe bazat e matematikës diskrete dhe do të mësojnë se si t'i zbatojnë ato në fushën e shkencave kompjuterike. Moduli përfshin tema nga: logjika matematike; bashkësitë; relacionet; pasqyrimet (funksionet); parimet elementare të numërimit; kuptimet themelore të teorisë së numrave; mosbarazitë elementare dhe teorinë themelore të grafeve.

4. Bazat e TIK

Ky modul synon të shërbejë si një hyrje në arkitekturën, strukturën, funksionet, komponentët dhe modulet e pajisjeve kompjuterike, duke ofruar njohuri mbi konceptet bazë të kësaj teknologjie.

Moduli ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në industrinë e IT-së dhe ekspozimin e thellë ndaj kompjuterëve personal, harduerit dhe sistemeve operative. Kandidatët mësojnë se si funksionojnë komponentët e ndryshëm të harduerit dhe softuerit dhe praktikën më të mira në mirëmbajtje, dhe siguri. Nëpërmjet aktiviteteve praktike laboratorike, kandidatët mësojnë se si të montojnë dhe konfigurojnë kompjuterët, të instalojnë sisteme operative dhe softuerësh dhe të zgjidhin problemet e harduerit dhe softuerit si dhe konceptet e rrjetave.

Moduli: IT Essentials: <https://www.netacad.com/courses/os-it/it-essentials>

Ky modul përgatitë kandidatët për çertifikim në CompTIA A+.

5. Hyrje në Programim

Moduli përqendrohet në analizën e problemit dhe zhvillimin e algoritmeve dhe programeve kompjuterike në gjuhë të nivelit të lartë – Java. Kandidatët do të fitojnë njohuri në konceptin e programimit kompjuterik, duke shfrytëzuar gjuhën programuese Java si mjet kryesor zhvillimi.

Ky modul ndihmon kandidatët në përdorimin e gjuhëve programuese Java, për të zgjidhur problemin, mësimin dhe praktikimin e komponentëve themelore të procesit të programimit, leximin dhe “debug”imin e programit në Java, kuptimin e sintaksës së gjuhës programuese Java, përgatitja për lëndë të avancuara, si Programimi i Orientuar në Objekte dhe Algoritmet dhe Struktura e të dhënave.

6. Algoritmet dhe strukturat e dhënave

Ky modul ofron një hyrje në algoritmet dhe strukturat e të dhënave, duke theksuar rëndësinë e tyre në zgjidhjen efikase të problemeve të ndryshme kompjuterike. Kjo lëndë ofron një hyrje në themelet e koncepteve bazike të programimit: strukturat e të dhënave dhe algoritmet. Shpjegon përdorimin dhe rëndësinë e strukturave bazë të të dhënave dhe demonstroi teknika të ndryshme algoritmike në fushat e kërkimit dhe renditjes (sortimit). Kjo lëndë poashtu njofton kandidatin me kompleksitetin e ekzekutimit i cili është esencial kur programet konfrontohen me versione të mëdha të problemeve për të cilat janë dizajnuar. Në përgjithësi moduli ofron një njohuri të përgjithshme teorike e cila është universale dhe e pavarur nga gjuha programuese.

7. Dizajnimi dhe zhvillimi i bazës së të dhënave

Moduli përfshin konceptet themelore dhe praktikën e nevojshme për dizajnimin dhe zhvillimin e bazës së të dhënave. Përmes këtij moduli kandidatët përgatiten për çertifikim në zhvillimin e bazës së të dhënave në SQL. Moduli për dizajnimin dhe zhvillimin e bazës së të dhënave ofron koncepte teorike për: të dhënat, normalizimin e të dhënave, strukturimin e të dhënave në tabela, modelimin relational të bazës së të dhënave, modelimin logjik dhe fizik të tabelave, krijimin e tabelave në MSSQL, indeksimin e tyre dhe manipulimin bazik me të dhëna në tabela.

8. Programimi i Ueb-it interaktiv

Qëllimi i këtij moduli është t'i sigurojë kandidatëve një kuptim të qëndrueshëm të koncepteve bazike të programimit në ueb dhe teknologjive që përdoren në këtë fushë. Moduli do të fokusohet në gjuhën kryesore të programimit në ueb JavaScript. Përmes këtij moduli, kandidatët do të zhvillojnë aftësitë që janë të nevojshme për të krijuar ueb faqe dinamike dhe interaktive. Gjithashtu, ata do të inkurajohen të zgjerojnë njohuritë e tyre edhe më tej në teknologjitë e tjera të programimit në ueb. Kjo përvojë e përgatitjes në programim të ueb-it do t'u jap aftësitë për të krijuar, menaxhuar dhe zhvilluar ueb faqe me efikasitet. Moduli synon të përgatisë kandidatët për sfidat e tregut të punës në fushën e programimit të ueb-it në mënyrë profesionale dhe të kualifikuar.

9. Programimi i Orientuar në Objekte

Ky modul ofron një hyrje në programimin e orientuar në objekte, duke theksuar rëndësinë e tyre në zgjidhjen reale të problemeve të ndryshme. Kandidatët do të pajisen me njohuri themelore dhe do të zhvillojnë aftësi për të dizajnuar modele e klasa të ndryshme që shërbejnë për krijimin e objekteve të ndryshme në Java, kompozicionin e tyre për zgjidhje të problemeve të ndryshme për sfida të ndryshme të jetës reale, trashëgimin e klasave apo ripërdorshmërinë e kodit si dhe sjelljet polimorfike deri tek dizanimet GUI.

10. Inxhinieria Softuerike

Në këtë modul do të mësohen parimet bazë të inxhinierisë softuerike. Temat që do të shtjellohen në këtë modul në mes tjerash janë edhe këto: Metodologjitë Zhvillimore, Kërkesat inxhinierike (Engineering Requirements), Dizajnimi i softuerit (Software Design), Zhvillimi dhe implementimi (Implementation). Moduli i'u mundëson kandidatëve të aplikojnë teknikat e orientuara në objekte në projektet e reja softuerike, të aplikojnë me sukses teknikën moderne modeluese, d.m.th. UML (Unified Modeling Language) në projektet softuerike.

Gjithashtu moduli ka për qëllim t'i pajisë kandidatët me njohuritë moderne në të "menduarit në objekte", parakusht ky i nevojshëm gjatë analizës dhe dizajnit të orientuar në objekte të sistemeve komplekse softuerike.

11. Zhvillimi i Ueb-it

Moduli ofron njohuritë bazë dhe të nevojshme për të zhvilluar aplikacione ueb duke përdorur gjuhën programuese Java duke përdorur Spring Framework. Objektivi kryesor i këtij moduli është të pajisë kandidatët me aftësitë bazë dhe njohuritë e nevojshme për të zhvilluar aplikacione ueb duke përdorur Spring Framework. Në fund të modulit, kandidatët do të jenë të aftë në server-side rendering me Thymeleaf, menaxhimin e lidhjeve të bazës së të dhënave, implementimin e sigurisë në aplikacionet ueb, dhe integrimin e teknologjive të Front end si JavaScript, AJAX, dhe Axios për një përvojë zhvillimi full-stack. Moduli synon të përziejë konceptet teorike me aplikimin praktik, duke mundësuar për kandidatët ndërtimin e zgjidhjeve të plota ueb.

12. Zhvillimi i aplikacioneve mobile

Ky modul mbulon konceptet dhe praktikën e nevojshme për krijimin dhe funksionalizimin e një aplikacioni mobil. Njoftim mbi platformën Android, metodat e zhvillimit të aplikacioneve në platformën Android duke filluar nga instalimi dhe konfigurimi i veglës Android Studio dhe emulatorit. Implementimi i ndërfaqes së përdoruesit dhe lidhja e saj me klasën në gjuhën programuese Java. Shembuj praktik të komponentëve më të përdorura në platformën Android. Segmentet teknike fokusohen në dizajnin dhe implementimin efektiv të aplikacioneve mobile në nivelin e përdoruesit.

13. Dizajni i ndërfaqes së përdoruesit dhe përdorshmëria

Ky modul eksploron parimet dhe teknikat e dizajnit dhe përdorshmërisë së ndërfaqes së përdoruesit, duke i pajisur kandidatët me aftësitë për të krijuar ndërfaqe digjitale intuitive dhe miqësore për përdoruesit që përmirësojnë përvojën e përgjithshme të përdoruesit. Nëpërmjet projekteve praktike dhe analizave kritike, kandidatët do të mësojnë të krijojnë ndërfaqe që i japin përparësi kënaqësisë, aksesit dhe efikasitetit të përdoruesit, duke i përgatitur ata për karrierë në krijimin e përvojave të jashtëzakonshme digjitale.

14. Zhvillimi i avancuar i Ueb-it

Ky modul synon të pajisë kandidatët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar aplikacione të plota ueb duke përdorur teknologjitë më të fundit në zhvillimin e backend-it dhe frontend-it. Pjesëmarrësit do të mësojnë si të krijojnë dhe të integrojnë komponentët e përparme dhe të pasme të një aplikacioni ueb, duke u fokusuar në praktikat më të mira dhe përdorimin e mjeteve moderne të zhvillimit.

Moduli synon të ndërtojë një bazë të fortë në konceptet e programimit të orientuar nga objektet dhe të përgatisë kandidatët për sfidat e zhvillimit të aplikacioneve në botën reale. Ky modul është dizajnuar për t'u ofruar kandidatëve një përvojë të thellë dhe praktike në zhvillimin e aplikacioneve moderne të ueb-it, duke i përgatitur ata për karriera si zhvillues full-stack.

Moduli është ndarë në dy faza kryesore, duke filluar me zhvillimin e backend-it duke përdorur Java Spring Boot dhe më pas duke kaluar në zhvillimin e frontend-it me Vue.js apo ReactJS.

15. Zhvillimi i avancuar i aplikacioneve mobile

Ky modul do të mbulojë konceptet dhe praktikat e nevojshme për krijimin dhe funksionalizimin e një aplikacioni mobil. Moduli i Zhvillimit të Avancuar të Aplikacioneve Mobile do të i'u përgatisë të publikoni aplikacionin tuaj të parë për platformën iOS, pavarësisht nëse jeni tashmë duke programuar ose sapo filloni. Ndërsa zotëroni gjuhën e programimit Swift dhe krijoni një portofol aplikacionesh për të shfaqur aftësitë tuaja, do të përfitoni nga shtjellimet e detajuara të kodit, këshillat e vlefshme për karrierën dhe stërvitjet nga zhvilluesit profesionistë të iOS. Ju do të filloni duke mësuar bazat e zhvillimit të aplikacioneve iOS duke përdorur gjuhën e programimit Swift dhe Xcode, mjeti i përdorur për zhvillim nga Apple. Do të zhvilloni aplikacionet tuaja të para për iOS duke përdorur paraqitjet, pamjet, UIKit dhe më shumë. Më pas, do të përparoni për të ndërtuar aplikacione më komplekse dhe më të avancuara, duke përdorur rrjetin dhe do të jeni gati për të publikuar projektin tuaj në App Store.

16. Hyrje në siguri kibernetike

Hyrje në siguri kibernetike është modul që përqendrohet në mbrojtjen e të dhënave në mjedisin e teknologjisë informative. Kandidatët mësojnë për sistemet kriptografike, rreziqet nga malware, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave. Moduli mëson se si të siguroni uebin nga aktivitetet e paautorizuara dhe mbulon problemet dhe kërcënimet kryesore të sigurisë në ueb dhe media mobile. Ai përfshin modelet bazë të sigurisë për ueb dhe platformat mobile, identifikimin e sulmeve në sigurinë e sistemit/aplikacionit, metodat e trajtimit të kodit të trashëguar, menaxhimin e sesionit dhe autentifikimin e përdoruesit, HTTPS, dhe identifikimin e grackave. Ky modul mëson kandidatët për parimet e sigurisë, siç është krijimi i një politike efektive të sigurisë dhe për llojet e ndryshme të aktiviteteve të hackerave.

17. Analiza dhe vizuelizimi i të dhënave

Moduli “Analiza dhe vizuelizimi i të dhënave” ofron një pasqyrë të përgjithshme të koncepteve dhe teknikave themelore në analizën e të dhënave, vizualizimin e tyre si dhe “machine learning”. Kandidatët do të mësojnë se si të eksplorojnë, analizojnë dhe vizualizojnë të dhënat duke përdorur gjuhën programuese Python dhe libraritë e njohura si Pandas, Matplotlib dhe Seaborn. Moduli përfshin bazat e algoritmeve “Supervised Learning”, me fokus në algoritmet “Linear Regression”, “Logistic Regression”, “Decision Trees” dhe “k-Nearest Neighbors (k-NN)”. Përmes projekteve dhe ushtrimeve praktike, kandidatët do të fitojnë përvojë praktike në manipulimin e seteve të të dhënave, krijimin e vizualizimeve dhe ndërtimin e modeleve parashikuese.

18. Hyrje në biznes

Ky modul ofron një pasqyrë të koncepteve themelore në biznes, duke përfshirë krijimin, menaxhimin, marketingun, financat, operacionet dhe etikën në aspektet e biznesit. Do të mësohen edhe elementet esenciale si krijimi i një biznes plani, analiza e biznesit dhe hulumtimi i tregut. Kandidatët do të eksplorojnë rolin e biznesit në shoqëri dhe do të zhvillojnë njohuritë bazë për parimet dhe praktikat kyçe në fushën e biznesit. Qëllimi i këtij moduli është të ofrojë një kuptim themelor të botës së biznesit për kandidatët, duke i përgatitur ata për të kuptuar dinamikën dhe sfidat e tregut të biznesit.

19. Hyrje në shitje

Moduli do t’i ndihmojë kandidatët dhe do të zgjerojë kuptueshmëritë mbi hulumtimin e tregut, segmentimin e tij, të kuptuarit e procesit të shitjes, dallimin në mes marketingut dhe shitjes, menaxhimin e relacioneve me klient, bazuar në industrinë e veçantë, duke filluar nga zanafilla e një kompanie e deri te internacionalizimi i saj. Kandidatët do të njihen me proceset e vendimmarrjes së një blerësi dhe momentet kyçe të vendimeve për blerje, në varësi të industrisë.

20. Menaxhimi i projekteve të TI

Ky modul mbulon fazat, metodat dhe shkathtësitë e menaxhimit të projekteve të TI-së nga fillimi e deri në fund në përmbyllje dhe dorëzim të projektit, produktit apo shërbimit. Qëllimi kryesor është prezantimi i dokumentacioneve të ndryshme që një projekt duhet të përmbajë, duke filluar nga Project Charter e deri te Finalizimi i Projektit.

Ky modul përgatitë kandidatët për çertifikim në CompTIA Project+.

21. Ndërmarrësia dhe inovacioni

Ky modul ka për qëllim t'i njoftojë studentët me konceptet bazë të ndërmarrësisë dhe inovacionit, me qëllim të stimulimit të menduarit dhe vepruarit si ndërmarrës. Moduli mbulon konceptet e ndërmarrësisë dhe inovacionit, historitë e tyre, si dhe rolin e tyre sot në shoqëri. Gjithashtu, ai trajton teoritë kryesore të ndërmarrësisë dhe inovacionit, dallimin nga menaxhmenti klasik, shtyllat bazë të modeleve të biznesit, burimet e mundshme të financimit të biznesit, ndikimin e teknologjisë dhe internetit në ndërmarrësi, si dhe rastet e studimit nga përvojat e ndërmarrësve të suksesshëm.

22. Testimi i Softuer-it

Qëllimi i modulit është që t'i pajisë kandidatët me njohuritë e nevojshme të teknikave moderne të testimit. Në fund të modulit, kandidatët do të kenë një vlerësim të një sërë teknikave të testimit, do të jenë në gjendje të kuptojnë teknikat e testimit rigoroz dhe të organizuar të softuer-it. Ata do të jenë në gjendje për të zgjedhur një strategji të përshtatshme për testim, sajimin e test rasteve (Test Case) të përshtatshme për testim, etj.

Kandidatët do të pajisen me njohuri të nevojshme për përpilimin, raste testimi/test case-ve për nivelet e ndryshme të testimit: 1. module, 2. integration, 3. system, dhe 4. acceptance tests.

Kandidatët do të jenë në gjendje gjithashtu që të aplikojnë metodat e testimit si kutia e zezë dhe metoda kutia e bardhë. Po ashtu kandidatët varësisht nga projekti përmes aplikimit të veglave si .NUnit dhe veglave tjera të ndryshme do të arrijnë edhe një testing coverage 100%.

23. Inteligjenca Artificiale

Inteligjenca Artificiale është një modul i fokusuar në bazat e Inteligjencës Artificiale, të nxënit e makinës dhe aplikimet e Inteligjencës Artificiale. Ky modul trajton konceptet e IA, zgjidhjen e problemeve me algoritmet e të nxënit të makinës dhe mjetet e ndryshme që përdoren në IA. Përdorimi i mjeteve të ndryshme të Inteligjencës Artificiale si Inteligjenca Artificiale për Gjenerim, për parashikim. Përfundimi i këtij moduli siguron njohuri dhe aftësi të nevojshme për të përdorur një sistem apo një kornizë të përdorimit të IA.

24. Marketingu Digjital

Ky modul ofron një kuptim të thellë të strategjive dhe teknikave të marketingut digjital në ambientin e tregut të sotëm. Në këtë modul do të mbulohen temat kryesore të marketingut digjital duke përfshirë strategjinë e përmbajtjes, SEO, reklamën në internet, rrjetet apo mediat sociale, analizën e performancës, e-commerce dhe strategjitë e përfshirjes së konsumatorëve në internet.

Na ndiqni në rrjetet tona sociale:<https://www.instagram.com/cactusedu/> <https://www.facebook.com/cactusedu> <https://www.tiktok.com/@cactusedu?lang=en> <https://www.linkedin.com/school/cactusedu/> 

Cactus Education është shkollë e lartë profesionale e nivelit të V e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe e licensuar nga MASHT-i.